



Deklaratat e analizuara:

15 Deklarata të analizuara

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri Përmirë/Vjetor 2017)

Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2017



Pasuria bruto nga fillimi i detyrës deri me datë 31.12.2017 është rritur 7.8 herë.

+ 1,009,250 lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë

Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë



Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2004-2017	Shuma në Lekë	Raporti në %
Të ardhura nga paga dhe shpërblime nga funksioni	16,453,320	46.8%
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	5,681,901	16.2%
Dhurata në Cash (nga e ëma e bashkëshortes)	400,000	1.1%
Të ardhura nga aktiviteti privat i bashkëshortes si notore	5,722,876	16.3%
Të ardhura nga Qira	333,048	0.9%
Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme	6,200,000	17.6%
Të ardhura të tjera	377,307	1.1%
<b>Total</b>	<b>35,168,452</b>	<b>100%</b>

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

Pa Probleme

Në vitin 2003, subjekti Artur Kalaja ka deklaruar se bashkëshortja e tij ka përfutur nëpërmjet dhurimit (nga e ëma) 1/12 pjesë të një shtëpie 2 kate dhe një truall 800 m<sup>2</sup> dhe në për ndërtim sipas kontratës së sipërmarrjes dt 12.12.2002. Mëk ka të dhëna mbi kashket e kësaj kontrate dhe pjesën takuese të sipërfaqes së ndërtimit në përfundim të kësaj kontrate. Si rrjedhje transaksionet në vitet në vijim që lidhen me këtë truall nuk janë të qarta dhe transparente.

Në vitin 2010, subjekti deklaron se ka "shtuar pasuri një ambient social zyrë 20 m<sup>2</sup> që përfiton bashkëshortja nga ndërtimi në pronën e saj". Sipas deklarimit, subjekti banon në këtë ambient, i dhënë nga firma ndërtuese me qira prej 200 eurosh në muaj.

Në vitin 2013, subjekti deklaron se: "mes bashkëshortes dhe shoqërisë Kamberi sh.p.k u lidh kontratë shkëmbimi date 05.11.2013, me të cilën kundrejt shkëmbimit të pjesës së truallit në rr.Lidhja e Prizrenit, bashkëshortja përfitoi: 1 Apartament me sip. totale 171.75 m<sup>2</sup>, 2. Njësi me sip. neto 20.2 m<sup>2</sup>, 3. Garazh me sip 31.72 m<sup>2</sup>. Bashkëshortja Flora Kalaja në vitin 2007 deklaroi që ka marrë nga nëna e saj Kudrete Hodo një pjesë të të ardhurave të fituara nga shitja e një shtëpie, viti në Dytelin e Durrësit, në shumën 400,000 lekë.

Në deklaratën periodike/vjetore 2015, subjekti deklaron se ka përfaqësuar me prokurorë babanë e tij, Sadik Kalaja, në ezekutim të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të të cilit Sherbimi Përmbarimor në 07.01.2015 ka dërdhur në BKI nga AKKP në favor të babat, Sadik Kalaja shumën prej 24 000' 000' 000' lekë. Kjo shumë nuk është përfshirë në asnjë nga llogaritjet e mesazheve të subjektit.